

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-05/05

Prishtinë, më 23 mars 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse e ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 105 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Zgjedhja e kryeministrit dhe e Qeverisë së Kosovës;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit "Për teatrin";
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit "Për ujitjen e tokave bujqësore";
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit "Për kujdesin ndaj kafshëve";
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit "Për mbrojtjen e natyrës";
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit "Për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme";
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit "Për inspektoratin e tregut";
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit "Për produktet e ndërtimit";
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit "Për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit".
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve";
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit "Për evidencën penale";
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit "Për shërbimet e shoqërisë informatike";

14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
15. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Telekomunikacion...lidhur me vendimin e panelit në Ligjin për transportin rrugor;
16. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit qendror për regjistrimin e popullsisë;
17. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Rregullator të Energjisë;
18. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe
19. Shqyrtimi i propozimit për zëvendësimin e dy anëtarëve të komisioneve të Kuvendit.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës të kësaj seance. Seanca e sotme, shtoi ai, përveç se është e rregullt, që do të miratohen një sërë ligjesh, është edhe e veçantë, sepse sot zgjedhim Qeverinë e re të Kosovës. Këtë e bëjmë pa kaluar as katër muaj nga zgjedhja e Qeverinë e mëparshme. Jo nga shkak se patëm krizë qeverisëse dhe institucionale, por nga shkak se Gjykata e Hagës ngriti akt padi kundër kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt, duke bërë kështu një ndërhyrje në proceset politike në Kosovës.

Qëndrimi i kryeministrit, Ramush Haradinaj, dorëheqja dhe shkuarja e tij vullnetare në Hagë, shpreh qëndrimin vetëmohues, të përgjegjshëm e largpamës, që si gjithëherë të jetë në shërbim të çështjes së Kosovës dhe të popullit të saj.

Gjatë kësaj kohe, Kryesia e Kuvendit ka mbajtur disa mbledhje dhe ka dalë me një kërkesë, në emër të Kuvendit, për mbrojtjen në liri të Ramush Haradinajt, që u është dërguar autoriteteve përkatëse.

Partnerët e koalicionit qeverisës kanë vendosur të vazhdojnë me koalicionin e deritashëm, i cili në periudhën e kaluar u tregua shumë i suksesshëm në realizimin e programit qeveritar, që e pat miratuar ky Kuvend.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Zgjedhja e kryeministrit dhe e Qeverisë së Kosovës

Kryetari i Kuvendit, në mungesë të kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, paraqiti propozimin e tij, me të cilin ai kishte nominuar z. Bajram Kosumin, për kryeministër të Kosovës.

Ai kishte kërkuar nga kryeministri i nominuar të bëjë kompletimin e Qeverisë në bazë të marrëveshjes së koalicionit dhe t'ia parashtrijë Kuvendit të Kosovës për miratim.

Kryetari e ftoi kandidatin e nominuar për kryeministër që Kuvendit t'ia paraqesë listën e kandidatëve të kabinetit qeveritar.

Kandidati i nominuar për kryeministër, Bajram Kosumi, e paraqiti listën e kandidatëve për ministra, për zëvendëskryeministër dhe për zëvendësministra të Qeverisë së Kosovës, si vijon:

- Adem Salihaj, zëvendëskryeministër i Qeverisë së Kosovës,
 - Hak Shatri, ministër për Ekonomi dhe Financa
 - Bujar Dugolli, ministër për Tregti dhe Industri,
 - Agim Veliu, ministër për Arsim, Shkencë dhe Teknologji,
 - Astrit Haraçia, ministër për Rini, Kulturë, Sport dhe Çështje Jorezidente,
 - Qemajl Ahmeti, ministër për Transport dhe Telekomunikacion,
 - Melihate Tërnkolli, ministre e Shërbimeve Publike,
 - Sadik Idriz, ministër i Shëndetësisë,
 - Lutfi Haziri, ministër i Vetëqeverisjes Lokale,
 - Et'hem Çeku, ministër i Energjetikës dhe i Minierave,
 - Ardian Gjini, ministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor,
 - Ibrahim Selmanaj, ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale,
 - Sllavisha Petkoviq, ministër për Kthim dhe Komunitete,
-
- Hafiz Krasniqi, zëvendësministër i Transportit dhe Telekomunikacionit,
 - Astrit Ajeti, zëvendësministër i Shëndetësisë,
 - Muharrem Ibrahimimi, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave,
 - Favzi Berisha, zëvendësministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
 - Aziz Lila, zëvendësministër i Pushtetit Lokal,
 - Merxhan Avdyli, zëvendësministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor,
 - Kadri Kryeziu, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë,
 - Agron Dida, zëvendësministër i Energjetikës dhe i Minierave,
 - Lulzim Leci, zëvendësministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale,
 - Mark Komoni, zëvendësministër i Shërbimeve Publike
 - Angjelina Krasniqi, zëvendësministre e Kulturës, Rinisë Sportit dhe i Çështjeve Jorezidente
 - Ibish Bajrami, zëvendësministër për Kthim dhe Minoritete,
 - Tomë Hajdaraj, zëvendësministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
 - Ergyn Kurugllu, zëvendësministër i dytë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente dhe
 - Nazmi Fejza, zëvendësministër i dytë në Ministrinë e Kthimit dhe të Minoriteteve.

Në vazhdim z.Kosumi tha se Qeveria, të cilën do ta udhëheq ai ,do të jetë vazhdimësi e Qeverisë së mëparshme.

Programi i Qeverisë së mëparshme, i miratuar para tre muajve , është punë e përbashkët e partnerëve në koalicion, si dhe e ekspertëve që kanë punuar për ne.

Prandaj, ai program do të jetë bazë edhe për Qeverinë e re.

Ne do të punojmë sipas një plani detaj të punës për vitin 2005, i cili mbështetet në programin e Qeverisë. Ky plan detaj i punës, koncentrohet në tri çështje themelore:

1. Realizimi i standardeve për Kosovën;
2. Zhvillimi ekonomik i vendit. Hartimi i legjislacionit të duhur, krijimi i mundësive për hapjen e vendeve të reja të punës dhe ndërmarrja e veprimeve për krijimin e një Fondi për zhvillim të Kosovës;

3. Fillimi i procesit të definimit të pavarësisë së Kosovës.

Kur të vijë koha e negociimit për pavarësinë e Kosovës, bashkë me Qeverinë dhe institucionet e tjera të Kosovës edhe opozita do ta ketë vendin e vetë meritë në këtë proces.

Për çështjet që janë me interes parësor kombëtar do të mundohem të krijoj konsensus me të gjitha forcat politike kryesore në Kosovë.

Fjalimi i plotë i z. Kosumi i është bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me propozimin për zgjedhjen e kryeministrit dhe të Qeverisë së Kosovës.

Gjynaze Sylja tha se Grupit Parlamentar i AAK-së e mbështetë propozimin për zgjedhjen e kryeministrit, zëvendëskryeministrit, ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Kosovës.

Alush Gashi tha se Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështetë propozimin për nominim që e ka bërë kryetari i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, dhe mbështet listën të cilën e paraqiti i nominuari për kryeministër të Qeverisë së Kosovës.

Jakup Krasniqi tha se Grupi Parlamentar i PDK-së nuk do të votojë as për të nominuarin për kryeministër as për listën e kandidatëve për ministra. Ai propozoi që të shtyhet zgjedhja e Qeverisë dhe të formohet një komision hetimor parlamentar për ta hulumtuar të kaluarën e disa kandidatëve për kabinetin qeveritar dhe t'ia paraqes Kuvendit raportin para se të votohet për ta.

Ai paraqiti pikëpamjet e këtij grupi parlamentar lidhur me formimin e Qeverisë dhe për zhvillimin e procese politike në Kosovë, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Hashim Thaçi (PDK) tha se institucionet dhe qytetarët e Kosovës nuk mund të sillen sikur nuk ka ndodhë asgjë.

-Sot në Hagë ndodhen lideri i Partisë së tretë në Kosovë, zoti Ramush Haradinajt dhe shefi i Grupit Parlamentar të PDK Fatmir Limaj. Ne besojmë në pafajësinë e tyre, por kjo nuk mjafton. Prandaj, Partia Demokratike e Kosovës propozon nxjerrjen e një rezolute nga ky Kuvend për mbrojtjen në liri të Ramush Haradinajt.

Nëse për dy partitë e koalicionit momental ishte e papranueshme ndërtimi i Qeverisë gjithëpërfshirëse shumë përfshirëse, atëherë Partia Demokratike e Kosovës për interesat madhore iu ofron bashkëpunim.

Partia Demokratike e Kosovës sot, pas sqarimeve plotësuese nga UNMIK-u për çështjet e ngritura më herët, shpreh gatishmërinë për të marrë pjesë në votim, nëse në kabinetin qeveritar nuk do të kishte njerëz të korruptuar dhe të involvuar në krimin e organizuar nga përbërja e kabinetit të kaluar.

Ne do të vazhdojmë të jemi opozitë, por do të ofrojmë ide dhe projekte më të avancuara për të gjitha fushat e zhvillimit të procese politike.

Veton Surroi (ORA) tha se Kuvendi duhet ta miratojë një deklaratë për mbrojtje të z. Haradinaj nga liria.

Qeveria e kaluar e kishte gojën përplot standarde, por përpos standardeve nuk kishte gjë për të thënë për çështje të tjera.

Kosova është jo vetëm në krizë, por është e izoluar nga zhvillimi i përgjithshëm i rajonit. Çështja fundamentale që do të duhej të shtronte një Qeveri, e cila ka vizion, është jo vetëm si të mbushë buxhetin e vet, por a mund të jetë Kosova fare pjesë e buxhetit evropian, të vitit 2007?

Është një rast i mirë për Qeverinë e re, po që se zgjedhet, që të përpiqet që të krijojë konsensus në këtë shoqëri lidhur me zhvillimin e proceseve madhore për Kosovën.

Emrash Xhemajli tha se LPK-ja kërkon që ky Kuvend të bëjë kërkesë nga Gjykata e Hagës që z. Ramush Haradinaj të mbrohet në liri.

Ne do ta votojmë kryeministrin dhe Qeverinë e propozuar.

LPK do të vazhdojë të jetë opozitë.

Mahir Jaxhillar tha se Grupi Parlamentar 6 + e mbështetë propozimin për zgjedhjen e kryeministrit dhe të kabinetit qeveritar.

Numan Baliq tha se pas dorëheqjes së kryeministrit është dashur të jep dorëheqje i tërë kabineti qeveritar.

Një numër i ministrave të propozuar nuk janë të aftë për t'i kryer obligimet që i kanë lidhur me përmbushjen e standardeve, procesin e decentralizimit dhe për negociimin e statusit përfundimtar të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me propozimin për kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra dhe zëvendësministra të Qeverisë së Kosovës dhanë edhe këta deputetë: **Nazim Jashari, Fatmire Kollçaku, Hajredin Kuçi, Genc Gorani, Enver Hoxha, Sabri Hamiti, Teutë Sahatçia, Sabit Rrahmani, Mark Krasniqi, Ylber Hysa dhe Sala Ahmetaj**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë propozimin për zgjedhjen e kryeministrit, zëvendëskryeministrit, ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Kosovës. Rezultati ishte si vijon:

Për-----71;

Kundër-----36.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, **zgjodhi** Qeverinë e Kosovës.

Kryetari e ftoi kryeministrin dhe kabinetin e tij ta jepnin betimin para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Kosumi i ftoi ministrat, zëvendëskryeministrin dhe zëvendësministrat të ngritën në këmbë për ta dhënë betimin.

Kryeministri e lexoi tekstin e betimit, si vijon: “ *Ne, anëtarët e Qeverisë së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës betohemi solemnisht se me përgjegjësi, me përkushtim dhe me ndershmëri do t'i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend – gjithmonë duke zbatuar ligjin dhe vendimet e miratuara, duke respektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci në*

*interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor e të gjithmbarshëm të popullit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës” Në fund, i gjithë kabineti qeveritar deklaroi: **B e t o h e m!***

Kryetari dha pauzë gjysmë ore.

Pas pauzës, seancën e kryesoi **Fatmir Sejdiu**, anëtar i Kryesisë.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për teatrin

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11(b), 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42(a), 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----85;

Kundër----- 7;

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për teatrin.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujitjen e tokave bujqësore

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3 dhe 4.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----92;

Kundër----- 0;

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për ujitjen e tokave..

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kujdesin ndaj kafshëve

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----92;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për kujdesin ndaj kafshëve.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11(b), 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----76;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11(b), 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28 dhe 29.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----72;
Kundër----- 3;
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspeksionin e tregut

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11(b), 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 19.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----80;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për inspektoratin e tregut.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL.

Ai i hodh në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----85;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi** Ligjin për produktet e ndërtimit.

Më 24 mars 2005
Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse e ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Bujar Dugolli, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Dugolli shpjegoi strukturën e Projektligjit, e radhitur në shtatë kapituj.

Kapitulli i parë përmban dispozitat e përgjithshme.

Kapitulli i dytë përcakton kërkesa teknike, me të cilat rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e kërkesave teknike për produktet që vendosen në treg nga ana e personave juridik dhe fizik

Kapitulli i tretë rregullon çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e konformitetit për produktet teknike para se të vendosen produktet e tilla në treg.

Kapitulli i katërt i referohet kërkesave të cilat duhet t'i plotësojnë organet për vlerësimin e konformitetit të produkteve.

Kapitullin i pestë përcakton një sërë rregullash përkitazi me vlefshmërinë e dokumenteve dhe shenjave të konformitetit të lëshuara jashtë Kosovës.

Kapitulli i gjashtë përmban dispozitat për mbikëqyrjen e inspektorëve, siç janë organet e inspektorëve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Kapitulli i shtatë përmban dispozitat kalimtare, të cilat janë pjesë e standardeve të të gjitha ligjeve në pajtim me teknikën legjislativë që zbatohet në Kosovë.

Për zbatimin e këtij projektligji është paraparë shuma prej 14.176 eurosh.

Në fund, ministri Dugolli i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Bajrush Xhemajli, Naim Maloku, Teutë Sahatçiu dhe Mahir Jakxhillar**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----86;
Kundër----- 9;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Kuvendi i ngarkoi komisionet e

veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri...– komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Bujar Dugolli, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Dugolli shpjegoi strukturën e Projektligjit, e radhitur në gjashtë kapituj dhe 12 nene.

Kapitulli i parë përmban dispozitat e përgjithshme, në të cilat janë specifikuar fushat dhe kategoritë që rregullon ky ligj.

Kapitulli i dytë përmban kërkesat e përgjithshme të sigurisë për produkte, që duhet t'i plotësojnë prodhuesit në eksport dhe import para se të vendosen produktet në treg .

Kapitulli i tretë përcakton rregullat përkitazi me detyrimet e prodhuesit dhe të shpërndarësit me rastin e vendosjes së produkteve në treg.

Kapitulli i katërt i referohet çështjeve që kanë të bëjnë me përcjelljen e zbatimit të ligjit nga organet inspektuese, në pajtim me kompetencat për produkte të caktuara, që dalin nga rregulloret mbi organizimin dhe veprimtarinë e punës së organeve të administratës shtetërore.

Në Kapitullin e pestë janë përcaktuar një sërë masash ndëshkimore në rast kur organet për inspektime konstatojnë se janë bërë shkelje të dispozitave të ligjit për sigurinë e produkteve.

Në fund, ministri Dugolli i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Ymer Halimi, Teutë Sahatçiu, Xhezair Murati, Naxhije Doçi, Teutë Hadri, Fetah Berisha dhe Nerxhivane Dauti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----79;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri...– komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për evidencën penale

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Fatmir Sejdiu tha se ky projektligj mund të jetë i pa objekt shqyrtimi. Çështja themelore është se referenca që vjen në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale nënkupton që evidenca penale të rregullohet me udhëzim administrativ. Sugjerimi im është që kjo materie të rregullohet me një udhëzim administrativ. Ky projektligj t'i kthehet Qeverisë dhe ajo të veprojë sipas ligjit.

Nerxhivane Dauti tha se ky projektligj nuk është i harmonizuar me Kodin e Procedurës Penale dhe i mungojnë dispozitat komplete përfundimtare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së propozoi që të shtyhet shqyrtimi i tij, për një seancë të radhës.

Zëvendëskryeministri **Adem Salihaj**, në emër të Qeverisë, tha se pajtohet me propozimet që të shtyhet shqyrtimi i këtij projektligji. Qeveria do ta rishqyrtojë se a është e domosdoshme të miratohet ligji apo kjo materie mund të rregullohet me një udhëzim administrativ.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e përfaqësuesve të dy grupeve parlamentare. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----79
Kundër----- 0;
Abstenime—0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës vendosi **t'ia kthejë** Qeverisë së Kosovës për rishqyrtim Projektligjin për evidencën penale.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Qemajl Ahmeti, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Ahmeti tha se me këtë projektligj, që është radhitur në nëntë kapituj dhe nëntëmbëdhjetë nene, rregullohen:

- nënshkrimet elektronike;
- përshtatja e kornizës së Unionit Evropian për tregtinë elektronike, që ka të bëjë me transaksione financiare dhe tregtare;
- definimi i standardit për mbrojtjen e konsumatorit;
- identifikimi i juridiksionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe
- mbrojtja e sistemit të rrjeteve kompjuterike nga palët e paautorizuara.

Ky projektligj do të ketë ndikim të madh në avancimin e shërbimeve të shoqërisë informative dhe në adaptimin e standardeve ndërkombëtare, ku përfshihen shërbimet bankare, blerja dhe shitja e mallrave, pagimi i tatimeve, ripërtëritja e patentë- shoferëve nënshkrimi elektronik etj. Njëherësh krijohet bazë e mirë për ruajtjen e fshehtësisë së

shërbimeve të telekomunikacionit, ku përfshihet sigurimi i rrjetit, vërtetësia, shifrimi dhe kodimi.

Në fund, ministri Ahmeti i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Brikenda Kryeziu, Hatixhe Hoxha, Mazllun Kumnova, Teutë Sahatçiu, Ramadan Kelmendi dhe Qibrije Hoxhai**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----92;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike . Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Postë dhe Telekomunikacion – komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij rekomandimi, **mori** këtë

V E N D I M

I. Miratohet rekomandimi i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si vijon:

1. Xhevat Dança, prokuror në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë;
2. Haxhi Sinanj, prokuror në Prokurorinë Publike të Qarkut në Pejë;
3. Rabije Jakupi, prokurore në Prokurorinë Publike Komunale në Gjilan;
4. Shaban Spahiu, prokuror në Prokurorinë Publike Komunale në Gjilan;
5. Zenije Kela, prokurore në Prokurorinë Komunale në Mitrovicë dhe
6. Shaip Merovci, gjyqtar në Gjykatën për Kundërvajtje në Zubin Potok.

II. Vendimi i parashtrohet PSSP, për veprim përfundimtar.

15. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Telekomunikacion...lidhur me vendimin e panelit në Ligjin për transportin rrugor

Kryetari i informoi deputetët lidhur me miratimin e Ligjit për transportin rrugor, si dhe sfidën e tij nga Grupi Parlamentar “Kthimi”.

Paneli i posaçëm që e kishte shqyrtuar mocionin e Grupit Parlamentar “Kthimi” i kishte rekomanduar Kuvendit që t’i miratojnë ndryshimet e propozuara në Ligjin për transportin rrugor, të cilin e kishte mbështetur edhe Komisioni parlamentar për Transport.

Kryetari e hodhi në votë rekomandimin e Panelit të posaçëm lidhur me këtë ligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----59;
Kundër----- 1;
Abstenime-----20.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi rekomandimin e panelit të posaçëm lidhur me Ligjin për transportin rrugor.

16. Shqyrtimi i propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit qendror për regjistrimin e popullsisë

Kuvendi, pas shqyrtimit të propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës, me shumicë votash mori

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT QENDROR PËR REGJISTRIMIN E POPULLSISË, TË EKONOMIVE FAMILJARE DHE TË BANESAVE

I. Miratohet propozimi i Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, si vijon:

1. Milihate Tërmkolli, kryesuese – MSHP;
2. Zahir Bajrami - ZKM;
3. Aziz Lila - MPL;
4. Gazmend Qorraj – MEF;
5. Makfire Mustafa – MKRSCJ;
6. Hakile Xhaferi – MBPZHR;
7. Stefan Zutt – PSHP;
8. Guven Guneren – ESK;
9. Hajzer Bublaku – AAK;
10. Hysni Thaçi – ESK;
11. Fikrim Damka dhe
12. Dragan Kukureković – MKK.

Deputetët e Grupit Parlamentar “ORA” e lëshuan seancën.

17. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Rregullator të Energjisë

Kuvendi, pas shqyrtimit të propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Propozim vendimi i kthehet Qeverisë së Kosovës, për rishqyrtim dhe t'ia propozojë Kuvendit emërimin e anëtarëve në Bordin e Rregullatorit të Energjisë, me arsimim adekuat, sipas kriterëve të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

18. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Komisionit të pavarur për miniera dhe minerale

Kuvendi, pas shqyrtimit të propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Propozim vendimi i kthehet Qeverisë së Kosovës për rishqyrtim dhe harmonizim, sipas kriterëve të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/2.

19. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e dy anëtarëve të komisioneve të Kuvendit

Kuvendi, pas shqyrtimit të propozimit të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e dy anëtarëve në komisionet parlamentare, mori këtë

V E N D I M

1. Në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të z. Naim Maloku, emërohet z. Mazllum Kumnova.
2. Në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në vend të znj. Myrvete Dreshaj, emërohet z. Ymer Halim.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 12:15 minuta.

Përgatitur nga

Sektori për Çështje Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat DACI**